



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Datë _____. 2014

UDHËZIM

Nr. 03, Datë 01.06.2010

**PËR SHPALLJEN E NJOFTIMIT TË KONTRATËS, NJOFTIMIT TË
FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR NË
SISITEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK, NDRYSHUAR ME
UDHËZIM NR.02, DATË 03.04.2014.**

Agjencia e Prokurimit Publik, mbështetur në nenin 13/2/d të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në respektim të ndryshimeve të fundit ligjore, që ka pësuar ligji i prokurimit publik, (ligji nr.10170, datë 22.10.2009), si dhe reflektimit të këtyre ndryshimeve në Rregullat e Prokurimit Publik udhëzon të gjitha autoritetet kontraktore, që zhvillojnë procedura prokurimi konform dispozitave të këtij ligji se:

Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, hedhja e njoftimit të kontratës, njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistem, bëhet nga vetë autoritetet kontraktore.

-Shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

-Shpallja e njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

-Pas mbylljes së fazës së klasifikimit të ofertave, autoritetet kontraktore do të presin afatin 7 ditor të ankimimit. Në përfundim të këtij afati, në rast se nuk ka ankesa, autoritetet kontraktore do të hedhin në sistem njoftimin e fituesit.

Shpallja e njoftimit të fituesit në faqen e internetit të APP do të bëhet publike ditën e nesërme të punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.¹

Autoritetet kontraktore duhet të bëjnë arkivimin e procedurave të prokurimit brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur. Mbyllja e fazës së arkivimit nuk ka nevojë për miratim nga APP.²

D R E J T O R I P È R G J I T H S H È M

Eduard Ahmeti

¹ Ndryshuar me Udhëzim Nr.02, datë 03.04.2014

² Shtuar me Udhëzim Nr.02, datë 03.04.2014